

Gabricë/Gabrica. Pas lufte, më 9.08.1999, mbetjet mortore të Agimit, Xheladinit dhe Besnikut janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kaçanik/Kaçanik. Agimi, pas vdekjes, është dekoruar me gradën gjeneral-major.

Burimet: SHFDUÇK, *Feniksët...2*, 39-42; SHFDUÇK, *Feniksët...3*, 175-177; SHFDUÇK, *Feniksët...4*, 61-63; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.52, FDH-30993; SMIP, *Terroristički...*, III, 448; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, X, 395, XXII, 847, XXIII, 236.

Đorđe (Čedomir) Đorđević

(6.05.1959, serb nga Gotovusha/Gotovuşa, komuna e Shtërpçës/Štrpce, tre fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Đorđe ka punuar në ndërmarrjen *Ivo Lola Ribar* në Shtërpçe/Štrpce. Nga muaji tetor të vitit 1995, ishte pjesëtar i forcave rezervë të policisë në Ferizaj/Uroševac. Në natën e datës **23.09.1998**, ai ishte duke patrulluar në **Doganaj/Doganović**, kur pjesëtarët e UÇK-së hapën zjarr ndaj tij. Đorđe u plagos për vdekje. Familja e ka varrosur më 25.09.1998 në varrezat në Gotovushë/Gotovuşa.

Burimet: deklarata M.Đ, FDH-36421; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.52, FDH-30993; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 26; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998.*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.
